

**UDHËZIM**  
**Nr. 499, datë 2.7.2019**

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE EMËRIMIT**  
**TË MJEKËVE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË**  
**REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NËPËRMJET PLATFORMËS ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 dhe të nenit 199 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”,

**UDHËZOJ:**

**KREU 1**  
**TË PËRGJITHSHME**

1. Ky udhëzim rregullon procedurat për punësimin e mjekëve në institucionet shëndetësore publike, nëpërmjet portalit “Mjekë për Shqipërinë”.

2. Procedurat për punësimin e mjekëve udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, barazisë dhe interesit më të lartë të shëndetit publik.

3. Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Mjekë për Shqipërinë”.

4. Drejtoria Qendrore e Operatori të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vazhdim “DQOSHKSH”) është institucioni përgjegjës për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të mjekëve në një vend të lirë pune në institucionet shëndetësore publike, ndërsa drejtoritë rajonale të shërbimeve të kujdesit shëndetësor (në vazhdim “DROSHKSH”) dhe drejtoritë e spitaleve universitare (në vazhdim “DSU”) respektivisht, organizojnë procedurat sipas këtij udhëzimi.

5. DROSHKSH-ja dhe DSU-ja kanë detyrimin të raportojë në DQOSHKSH vendet vakant për të cilat do të shpallet konkurrimi në 5 (pesë) ditët e para të çdo muaji.

6. DQOSHKSH ka detyrimin të shpallë në portalin “Mjekë për Shqipërinë” përgjatë gjithë vitit, vendet e lira të punës për çdo institucion shëndetësor publik sipas kërkesës së tyre, si dhe listën e punësimeve të kryera në muajin paraardhës brenda 5 (pesë) ditëve të para të çdo muaji.

7. Për të marrë pjesë në Programin e Bonusit mjeku specialist aplikon përmes platformës elektronike “Mjekë për Shqipërinë”.

8. Procesi i konkurrimit zhvillohet për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin për ushtrimin e profesionit të mjekut, si dhe kriteret specifike të pozicionit të punës.

9. Kandidatët e interesuar për t'u punësuar si mjekë në institucionet shëndetësore publike marrin pjesë në konkurrim, i cili zhvillohet në dy faza:

- a) konkurrimi me dosje;
- b) intervista.

**KREU II**  
**SHPLLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS DHE APLIKIMI**

1. Institucionet shëndetësore publike në varësi të OSHKSH-së raportojnë vendet e lira të punës që krijohen pranë drejtorive rajonale të OSHKSH-së.

a) Drejtoritë rajonale të OSHKSH-së analizojnë nevojën për pozicionin e punës (mjek) të mbetur vakant, nëse vlerësohet se për këtë pozicion nuk plotësohet ngarkesa e punës dhe është i panevojshëm për institucionin, deklarohet në Ministri si pozicion tepër. Për pozicionet mjekë, të mbetura vakante, për të cilat do të hapen procedurat e konkurrimit, DROSHKSH-të përgatisin listën sipas institucioneve shëndetësore publike dhe i dërgojnë pranë DQOSHKSH-së, e cila përgatit shpalljen dhe i publikon në portalin “Mjekë për Shqipërinë”.

b) Qendrat spitalore universitare identifikojnë vendet vakant për mjekë sipas shërbimeve dhe përgatisin shpalljen. Qendrat spitalore universitare dërgojnë shpalljen e vendeve të lira pranë DQOSHKSH-së e cila ka përgjegjësinë për ti publikuar në portalin “Mjekë për Shqipërinë”.

2. Shpallja e vendeve vakant për mjekë familje/mjekë të përgjithshëm bëhet e grupuar mbi bazë të njësisë vendore të kujdesit shëndetësor (në vijim “NJVKSH”). Shpallja e vendeve vakant mjekë specialistë në spitale/poliklinika dhe qendra shëndetësore bëhet për pozicion sipas specialitetit përkatës.

3. Shpallja në portalin “Mjekë për Shqipërinë” përmban këto të dhëna:

- a) kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë kandidati për pranim;
- b) fushën kryesore mbi të cilën do të bazohet intervista;
- c) dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;
- d) afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
- e) datën e shpalljes së verifikimit paraprak të kandidatëve;
- f) mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në fazën e verifikimit paraprak, si dhe intervistën;
- g) mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

4. Kandidatët e interesuar, regjistrohen në portalin “Mjekë për Shqipërinë” dhe ngarkojnë në portal dokumentet e kërkuar. Një kopje e dokumenteve dërgohet pranë DQOSHKSH-së apo spitaleve universitare me postë ose dorazi me protokoll. Afati i aplikimit është jo më pak se dy javë kalendarike nga data e shpalljes së vendit vakant.

5. Dosja e aplikimit përmban:

- a) jetëshkrimin e kandidatit (CV), (i detyrueshëm);
- b) librezën e punës;
- c) diplomën universitare dhe listën e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (e detyrueshme);
- d) diplomën e specializimit dhe listës së notave (e detyrueshme nëse pozicioni i punës është për mjek specialist);
- e) lejen e ushtrimit të profesionit (e detyrueshme);
- f) dëshmi të kualifikimeve shkencore (gradë ose titull akademik/shkencor);
- g) dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja;
- h) certifikatat e pjesëmarrjes në aktivitetet e edukimit në vazhdim të ndjekura brenda dhe jashtë vendit;
- i) deklaratë për gjendjen gjyqësore (e detyrueshme) sipas shtojcës 3;
- j) raporti mjekoligjor i tre muajve të fundit (i detyrueshëm në momentin e fillimit të detyrës).

6. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme si më sipër, skualifikohet. Kandidatët të cilët janë të punësuar në një institucion shëndetësor publik nuk mund të konkurrojnë nëpërmjet kësaj platforme, për ata do të zbatohen procedurat e lëvizjes paralele brenda NJVKSH-së.

### KREU III VLERËSIMI DHE EMËRIMI

1. Kandidatët do të vlerësohen për diplomën, gjuhën e huaj, përvojën në shëndetësi, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për intervistën me gojë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 50 pikë, përkatësisht:

- a) deri në 45 pikë vlerësimi i dosjes;
- b) deri në 5 pikë vlerësimi i intervistës me gojë.

Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve, përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Komisioni i Vlerësimit, brenda pesë ditëve pune pas përfundimit të afatit të pranimi të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe brenda dy ditëve shpall emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e pranimi dhe ia dërgon DQOSHKSH-së për t'i publikuar në portalin “Mjekë për Shqipërinë”.

3. Komisioni i Vlerësimit në të njëjtën ditë, që publikohet lista me emrat e kandidatëve, i njofton ata nëpërmjet adresës së *e-mail*-it, të cilën e ka dhënë kandidati për komunikim, për pikët që ka marrë nga vlerësimi i dosjes, si dhe për datën dhe vendin e intervistës. Gjithashtu,

Komisioni i Vlerësimit njofton me *e-mail* dhe kandidatët që nuk janë kualifikuar për arsyet e moskualifikimit.

4. Kandidatët kanë të drejtë ankimi brenda dy ditëve nga njoftimi i tyre. Ankesa bëhet nëpërmjet portalit “Mjekë për Shqipërinë”.

5. Komisioni i Vlerësimit ditën e intervistës përgatit pyetjet të cilat duhet të jenë të njëjta për të gjithë kandidatët. Në përfundim hartohet lista me pikët totale për çdo kandidat dhe brenda dy ditëve i njofton ata për rezultatin, nëpërmjet adresës së tyre me *e-mail*.

6. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit për rezultatin përfundimtar, brenda dy ditëve nga dita e njoftimit të tyre. Ankesa bëhet përmes portalit “Mjekë për Shqipërinë”.

7. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankimuesit me shkrim ose sipas formës që do të dakordësohet.

8. Pas përfundimit të afateve të ankimit dhe shqyrtimit të ankesave, Komisioni i Vlerësimit shpall renditjen e kandidatëve dhe e dërgon pranë DQOSHKSH-së, e cila menjëherë bën publikimin në portalin “Mjekë për Shqipërinë”.

9. Kandidati mjek familje/mjek i përgjithshëm i cili në renditjen e përgjithshme sipas NJVKSH-ve, është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendet e lira të punës në institucionet shëndetësore të NJVKSH-së përkatëse dhe është i detyruar të konfirmojë në DROSHKSH brenda 24 orëve, nga njoftimi për përzgjedhje, në adresën elektronike. Në rast se DROSHKSH-ja nuk merr konfirmim nga kandidati brenda këtij afati, atëherë vendi vakant i ofrohet kandidatit të radhës. Kandidati që nuk konfirmon pranimin e pozicionit të punës ose e refuzon atë, mbetet në listën e pritjes me të njëjtat pikë deri në shpalljen e radhës për konkurrim.

10. Kandidati fitues që përzgjedh vendin e punës në institucionet në varësi të OSHKSH-së, merr aktin e emërimit nga DROSHKSH-ja dhe paraqitet pranë institucionit shëndetësor për të lidhur kontratën e punës. Titullari i institucionit lidh kontratë pune pa afat me mjekun që zë një vend të lirë pune. Periudha e provës është tre muaj.

11. Kandidati mjek specialist që ka konkurruar për një spital/poliklinike/QSH i cili në renditjen e përgjithshme për këtë institucion, është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës në atë institucion dhe është i detyruar të konfirmojë në spitalin universitar/DROSHKSH përkatës brenda 24 orëve, nga njoftimi për përzgjedhje, në adresën elektronike. Në rast se spitali universitar/DROSHKSH-ja nuk merr konfirmim nga kandidati brenda këtij afati, atëherë vendi vakant i ofrohet kandidatit të radhës. Drejtoritë e spitaleve universitare bazuar në statutet e tyre, mund të vendosin një kufi minimal pikësh për tu konsideruar kandidat fitues.

12. Kur dy kandidatë kanë pikë të barabarta, përzgjedhja e vendit të punës bëhet nga kandidati që i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuar nëse ka të tillë, nëse nuk ka PAK, vendi i punës i ofrohet kandidatit që ka mesataren më të larta në listën e notave të diplomës universitare.

13. DROSHKSH-ja/spitali universitar dokumenton procesin e zgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat, si dhe raporton me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare në DQOSHKSH, si dhe në MSHMS, brenda datës pesë të çdo muaji për emërimet/refuzimet apo moskonfirmimet e kandidatëve.

14. Përkatësisht, Drejtoria Rajonale e OSHKSH-së të rajonit përkatës ose qendrat spitalore universitare nxjerrin aktin e emërimit për fituesin. Kandidati i shpallur fitues lidh kontratë individuale pune me institucionin shëndetësor.

15. Kandidatët mjekë familje/mjekë të përgjithshëm, për të cilët nuk ka një vend vakant, qëndrojnë në listën e pritjes për një vend pune në NJVKSH ku është kualifikuar, deri në shpalljen e radhës.

16. DROSHKSH-ja dhe DSP-ja dërgojnë listën me emrat e fituesve pranë DQOSHKSH-së e cila ka detyrimin të publikojë menjëherë në portalin “Mjekë për Shqipërinë”.

#### KREU IV KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë:

a) DQOSHKSH-ja krijon komisionet për vlerësimin e kandidatëve për mjekë në spitalet rajonale e bashkiake/NJVKSH dhe në qendrat shëndetësore, me përbërjen si më poshtë:

1. Drejtori i DROSHKSH-së kryetar;
2. Një përfaqësues nga DQOSHKSH-ja anëtar;
3. Një përfaqësues nga shërbimi spitalor ose NJVKSH-ja anëtar.

b) Spitalet universitare krijojnë komisionet për vlerësimin e kandidatëve për mjekë në institucionet respektive, me përbërjen si më poshtë:

1. Drejtori ose nëndrejtori kryetar;
2. Një përfaqësues nga shërbimi mjekësor përkatës anëtar;
3. Një përfaqësues nga njësia e burimeve njerëzore anëtar.

c) Në rastet kur një kandidat aplikon njëkohësisht në më shumë se një pozicion pune, që duhet të vlerësohet nga më shumë se një komision, DQOSHKSH-ja krijon komision *ad hoc* për vlerësimin e dosjes së kandidatëve me përfaqësues të komisioneve, sipas pikave “a” dhe “b”.

2. Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në DROSHKSH dhe DSU, kryen rolin e sekretarit teknik për mbajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të aplikantëve.

3. Anëtarët e komisionit duhet të verifikojnë dhe të shmangin konfliktin e interesit me kandidatët (shtojca 2).

4. Komisioni kryen detyrat si më poshtë:

- a) administron dosjet e aplikantëve që kanë aplikuar në portalin “Mjekë për Shqipërinë”;
- b) vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati, sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim;
- c) bën intervistimin e kandidatëve;
- d) bën njoftimin e kandidatëve për pikët e vlerësimit;
- e) shqyrton ankesat e kandidatëve;
- f) bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra në secilën fazë të vlerësimit dhe ato në total në përfundim të vlerësimit;
- g) dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DQOSHKSH dhe në MSHMS listën me pikët për çdo kandidat.
- f) dërgon procesverbalet dhe materialet e tjera të konkurrimit pranë drejtorive rajonale të OSHKSH-së apo drejtorisë së spitalit universitar përkatës.

## KREU V

### PLOTËSIMI I VENDEVE VAKANTE NËPËRMJET PROGRAMIT TË BONUSIT

1. MSHMS-ja shpall vendet vakant për mjekë specialistë në spitalet rajonale/bashkiake për të cilat do të aplikohet Programi i Bonusit.

2. Kandidatët që aplikojnë në Programin e Bonusit kur janë të punësuar në institucionet shëndetësore publike, duhet të marrin leje nga institucioni ku punojnë për pjesëmarrje në Programin e Bonusit.

3. Kandidatët që aplikojnë në këtë program, përveç dokumenteve sipas pikës 6, të kreu I, duhet të dorëzojnë dhe vërtetim nga njësia administrative për vendbanimin.

4. MSHMS-ja krijon Komisionin e Vlerësimit për aplikantët në Programin e Bonusit. Komisioni i vlerësimit administron dokumentet e aplikantëve, zhvillon intervistën me kandidatët dhe zgjedh fituesin mbi bazën e përcaktimeve të urdhrit të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5. Mjeku specialist që fiton nga Programi i Bonusit lidh kontratë me MSHMS-në, me institucionin shëndetësor ku do të punojë dhe me Drejtorinë Rajonale të FSDKSH-së.

6. Në përfundim të kontratës mjeku specialist kthehet në vendin e mëparshëm të punës.

## KREU VI

### PROCEDURA E LËVIZJES PARALELE DHE TRANSFERIMI

1. Procedura e lëvizjes paralele për mjekë të përgjithshëm /mjekë familje, bëhet për plotësimin e vendeve të lira vetëm brenda NJVKSH-së përkatëse.

2. Mjekët e emëruar nëpërmjet portalit “Mjekë për Shqipërinë” u lind e drejta për të kërkuar lëvizje paralele pasi të kenë mbushur 2 (dy) vite në të njëjtin vend pune.

3. Mjeku bën kërkesë për lëvizje paralele nga një qendër shëndetësore në një tjetër qendër shëndetësore pranë NJVKSH-së përkatëse. NJVKSH-ja merr masa për mbulimin e shërbimit në qendrën nga e cila kërkon të largohet mjeku dhe e dërgon kërkesën për miratimin e lëvizjes pranë DROSHKSH-së.

4. Lëvizjet paralele raportohen nga DROSHKSH-ja, brenda datës pesë të çdo muaji, pranë DQOSHKSH-së dhe Ministrisë.

5. Transferimi i mjekëve jashtë NJVKSH-së ku është i punësuar, bëhet me miratim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

## KREU VII MASA DISIPLINORE DHE LARGIMI NGA PUNA I MJEKËVE

1. Procedura disiplinore ndaj mjekut fillon nga drejtori/titullari i institucionit ku është i punësuar.

2. Shkeljet disiplinore, si rregull përcaktohen në kontratën individuale të punës, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Procedura disiplinore duhet të garantojë të drejtën e punonjësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, si dhe të drejtën për tu ankuar ndaj vendimit përfundimtar.

4. Mjeku mund të pezullohet nga puna për shkaqe të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjatë kohës së pezullimit, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet financiare.

5. Largimi nga puna i mjekut bëhet nga drejtori/titullari i institucionit sipas akteve ligjore në fuqi dhe njoftohet NJVKSH-ja/DROSHKSH-ja dhe DQOSHKSH-ja.

## KREU VIII DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra në zbatimin e këtij udhëzimi ruhen pranë drejtorive rajonale të OSHKSH-së ose institucionit qendror shëndetësor dhe janë objekt verifikimi nga MSHMS-ja.

2. Udhëzimi nr. 402, datë 14.5.2019 “Për procedurat e punësimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”, urdhri i ministrit nr. 355, datë 18.8.2014 “Për kriteret e punësimit të mjekëve në spitalet universitare”, urdhri nr. 511, datë 13.12.2011 “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor Publik”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi MSHMS-ja, Drejtoria Qendrore dhe Drejtoritë Rajonale të OSHKSH-së, si dhe institucionet shëndetësore publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
**Ogerta Manastirliu**

### SHTOJCA 1 KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR MJEKË TË PËRGJITHSHËM DHE MJEKË SPECIALISTË

| Nr. | Treguesit dhe kriteret                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Pikët      |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| 1.  | Përvoja në punë si mjek (një pikë për çdo vit pune, deri në 15 vite eksperiencë pune).                                                                                                                                                                                                                                                     | 1-15 pikë  |
| 2.  | Nota mesatare e studimeve të larta, vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:<br>Nota mesatare (e thjeshtë) 5.00 - 5.50 = 1 pikë;<br>Nota mesatare (e thjeshtë) 5.51 - 6.00 = 2 pikë;<br>Nota mesatare (e thjeshtë) 6.01 - 6.50 = 3 pikë;<br>Nota mesatare (e thjeshtë) 6.51 - 7.00 = 4 pikë;<br>Nota mesatare (e thjeshtë) 7.01 - 7.50 = 5 pikë; | 5 -10 pikë |

|    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |            |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
|    | Nota mesatare (e thjeshtë) 7.51 - 8.00 = 6 pikë;<br>Nota mesatare (e thjeshtë) 8.01 - 8.50 = 7 pikë;<br>Nota mesatare (e thjeshtë) 8.51 - 9.00 = 8 pikë;<br>Nota mesatare (e thjeshtë) 9.01 - 9.50 = 9 pikë;<br>Nota mesatare (e thjeshtë) 9.51 - 10.00 = 10 pikë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |            |
| 3. | Nota mesatare e studimeve të specialitetit, vlerësimi bëhet sipas pikës 2.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 5-10 pikë  |
| 4. | Dëshmi të njohjes së gjuhës/vet të huaja:<br>Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 2 pikë;<br>Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli B1 = 2 pikë;<br>Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli B2 = 4 pikë;<br>Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve universitare të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës.<br>Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund të llogariten më shumë se 5 pikë në vlerësimin e dosjes.<br>Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do të llogariten pikë vetëm për një dëshmi. | 0 - 4 pikë |
| 5. | Grada shkencore - maksimumi 4 pikë;<br>Studime doktorature në shëndetësi - 4 pikë;<br>Studime master në menaxhim shëndetësor - 2 pikë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | 0- 4 pikë  |
| 6. | Diploma dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën - maksimumi 2 pikë:<br>a. kualifikime nga 3 deri në 6 muaj - 1 pikë;<br>b. kualifikime 6 muaj e më shumë - 2 pikë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 0-2 pikë   |

## SHTOJCA 2

### DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Deklaroj në përgjegjësinë time, se në procesin e konkurrimit për pozicionin mjek pranë \_\_\_\_\_ që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_, nuk jam në konflikt interesi me asnjë prej kandidaturave të paraqitura për konkurrim.

DEKLARUESI

DATA

## SHTOJCA 3

### DEKLARIM I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër:

Datëlindja:

Vendlindja:

Dokumenti i identifikimit: (kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: i/e padënuar i/e dënuar

Emër, mbiemër:

Firmë:

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre.

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale, në vijim të përdorimit të këtij autorizimi, do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.